



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:177256
Datë: 02.07.2024
Numri i dokumentit: 05887061
K.DH.SH.II.nr.628/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryetar, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Q.M. "Tema" O.P me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.301/22 të datës 25.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit Q.M. "Tema" O.P me seli në Ferizaj, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.301/22 i datës 25.01.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.301/22 të datës 25.1.2024, është refuzuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit Q.M. "Tema" O.P., me NUI 810645591, me seli në Ferizaj kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar anulim të Vendimit të Paneli shqyrtues të OSHP-së PSH nr. 678/20 të dt. 13.11.2020 dhe kompensim dëmi, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2, pika n), lidhur me nenin 160.4 të LPK dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike neni 63 i LKA-, lidhur me nenin 181.1, pika b) e LPK, me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e paraqitur nga paditësi Q.M. "Tema" OP, të anulohet aktgjykimi KA.nr.301/22 e datës 25.01.2024 dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje pranë dhomave të shkallës së parë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2024 i padituri e konteston në tërësi ankesën e paditësit dhe i propozon gjykatës që e njëjta të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i

Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ KA.nr.301/22 i datës 25.01.2024.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me vendimin PSH. nr.678/20 i datës 213.11.2020, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik Q.M. “Tema” O.P – Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve televiziv për nevojat e MM FSK” me nr. të prokurimit: 217-20-35999-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Mbrojtjes dhe është vërtetuar njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull ”Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve televiziv për nevojat e MM FSK” me nr. të prokurimit: 217-20-35999-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Mbrojtjes.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 12.12.2020, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës OSHP-së, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 15.11.2023 dhe 23.01.2024, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e refuzon si të pabazuar me arsyetimin se Gjykata vlerëson se mospublikimi i kontratave të prokurimit në përgjithësi dhe mos publikimi i kontratës së prokurimit në rastin konkret me nr. 3750/19 e datës 04.10.2019, e lidhur nga AK (RTK) dhe N.SH. “Pro Media”, është moszbatim i përgjegjësive ligjore nga vet KRPK si dhe moszbatim i detyrimeve ligjore të AK “RTK” për çka si autoritetet publike duhet ti mbajnë përgjegjësinë ligjore për mos transparence në procedurë të prokurimit publik. Mirëpo, pretendimi i paditësit se kontrata është fiktive është e pabazuar në prova sepse gjykata vlerëson se kontrata nr. 3750/19 e datës 04.10.2019, pason nga Njoftimi për dhënies së kontratës B08, të shpallur në <https://e-prokurimi.rksgov.net>, nga autoriteti kontraktues RTK për aktivitetin e prokurimit me nr. 2018/RTK-18-3202-2-2-1/B08-0010587 Me titull: Lot 1 OB-van HD për realizimin e programeve të RTK-së (seriale, emisione, sporte vendore, programi i natës etj) në formatin me rezulacion të lartë HD 1920x1080 Lot 2 Uplink dhe OB - van HD për realizimin teknik të eventeve ndërkombëtare sportive të Përfaqësueses së Kosovës si nikoqir, me rezolucion full HD 1920x1080 sipas standardeve të organizatës ndërkombëtare–FIBA, në vlerën e parashikuar 80,000.00€. Realizimi i kontratës është i mbështetur në referencë të datës 05.08.2020, të lëshuar nga AK “RTK”, Faturat me nr.0066/2019 e datës 02.12.2019, nr. 0070/2020 e datës 03.02.2020 me shumë për pagesë 13,860.00€, Faturë me nr.0071/2020 e datës 03.02.2020 në shumë prej 16,170.00€, Faturë me nr 0072/2020 e datës 10.04.2020, Fature me

nr. 0067/2020 e datës 03.01.2020, Fature me nr.1006625 e datës 09.12.2020-për hapësirat reklamuese për periudhën 01.11.2020 deri me 02.11.2020, faturat tjera për pagesën e hapësirës reklamuese: 1001363, 1006466, 1006532, -se dhe OE "Promedia", Vendim të RTK me nr.3745/19 datë 04.10.2019. Sa i përket pretendimeve të paditësi lidhur me mënyrën e realizimit të pagesës/kompensimit të kontratës, gjykata sqaron se mbikëqyrja e shpenzimit të 14 fondeve publike dhe e zbatimit të kontratës bie në përgjegjësi të institucioneve kompetente konform Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nuk përbën çështje të shqyrtimit në këtë konflikt administrativ. Pretendimi se shërbimet e kryera sipas Kontratës nr. 3750/19 e datës 04.10.2019 në aktivitetin e prokurimit 2018/RTK-18-3202-2-2-1/B08-0010587, nuk janë te njëjta as te ngjashme me kërkesat nga Dosja e Tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e prodhimit te spoteve televizive dhe dokumentarve televiziv për nevojat e MM FSK" - me nr. prokurimi: 217- 20-3599-2-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Ministria e Mbrojtjes, kjo gjykatë duke pas parasysh, qëllimin e kontratës: Lot 1 OB-van HD për realizimin e programeve të RTK-së (seriale, emisione, sporte vendore, programi i natës etj) në formatin me rezulacion të lartë HD 1920x1080 Lot 2 Uplink dhe OB - van HD për realizimin teknik të eventeve ndërkombëtare sportive të Përfaqësueses së Kosovës si nikoqir, me rezolucion full HD 1920x1080, sipas standardeve të organizatës ndërkombëtare –FIBA, vlerëson si te pabazuar dhe konsideron se dëshmitë janë përputhje me kërkesat e Dosjes së tenderit, të vlerësimit të kapacitetit teknik dhe profesional, pjesa 9.1 & 9.2 ku përcaktohet se në Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkohet që OE duhet te ofroje se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte apo te ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), sipas të cilave shërbimet janë jo domosdoshmërisht identike të njëjta por mund të jenë edhe të ngjashme. Prandaj gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk ka arritur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së PSH nr. 678/20 të dt. 13.11.2020, më të cilin është vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës më titull të aktivitetit të prokurimit me titull: "Shërbimet e prodhimit te spoteve televizive dhe dokumentareve televiziv për nevojat e MM FSK" me nr. te prokurimit: 217-20-3599-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Mbrojtjes, për OE të rekomanduar si ofertues i përgjegjshëm dhe ofertues me çmimin më të lirë.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2, pika n), lidhur me nenin 160.4 të LPK dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike neni 63 i LKA-, lidhur me nenin 181.1,

pika b) e LPK, ngase në aktgjykimin e atakuar janë dhënë arsye të pasakta, haptazi kontradiktore dhe të paqëndrueshme lidhur me natyrën e kontratës nr.3750/19 të datës 04.10.2019, të lidhur mes RTK dhe N.Sh. “Pro Media”, si dhe efektet e saj në raport me kërkesat nga pika 9.1 dhe 9.2 të FDT, si dokument mbi bazën e të cilës Dhomat e shkallës së parë kanë vlerësuar përshtatshmërinë profesionale të OE të rekomanduar për kontratë në aktivitetin lëndor të prokurimit. Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara për faktin se aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i kësaj gjykate e pranon si të bazuar arsyetimin e aktgjykimit të Dhomës së Shkallës së Parë, lidhur vlerësimin e kësaj kontrate në të cilin është konstatuar se kontrata nr. 3750/19 e datës 04.10.2019, pason nga Njoftimi për dhënies së kontratës, nga autoriteti kontraktues RTK për aktivitetin e prokurimit me nr. 2018/RTK-18-3202-2-2-1/B08-0010587 Me titull: Lot 1 OB-van HD për realizimin e programeve të RTK-së (seriale, emisione, sporte vendore, programi i natës etj.) në formatin me rezulacion të lartë HD 1920x1080 Lot 2 Uplink dhe OB - van HD për realizimin teknik të eventeve ndërkombëtare sportive të Përfaqësueses së Kosovës si nikoqir, me rezolucion full HD 1920x1080 sipas standardeve të organizatës ndërkombëtare–FIBA, në vlerën e parashikuar 80,000.00€. Realizimi i kontratës është i mbështetur në referencë të datës 05.08.2020, të lëshuar nga AK “RTK”, Faturat me nr.0066/2019 e datës 02.12.2019, nr. 0070/2020 e datës 03.02.2020 me shumë për pagesë 13,860.00€, Faturë me nr.0071/2020 e datës 03.02.2020 në shumë prej 16,170.00€, Faturë me nr 0072/2020 e datës 10.04.2020, Fature me nr. 0067/2020 e datës 03.01.2020, Fature me nr.1006625 e datës 09.12.2020-për hapësirat reklamuese për periudhën 01.11.2020 deri me 02.11.2020, faturat tjera për pagesën e hapësirës reklamuese: 1001363, 1006466, 1006532, -se dhe OE “Promedia”, Vendim të RTK me nr.3745/19 datë 04.10.2019. Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i Dhomës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që Dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Aktgjykimi i kontestuar përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.628/24 datë 01.07.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi